

3 nëntor 2025,
Prishtinë

Vendim i Bordit të FBK-së i datës 03.11.2025, Prishtinë

Miratimi i propozimit për organizimin e eventeve ndërkombëtare gjatë verës 2026 në konkurrencën e femrave

Në përputhje me kompetencat e Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) që dalin nga Statuti dhe duke u bazuar në propozimin e Kryetarit të FBK-së, z. Arben Fetahu, më 03.11.2025, Bordi i FBK-së ka miratuar propozimin për organizimin e eventeve ndërkombëtare gjatë verës së vitit 2026 në konkurrencën e femrave, si në vijim:


1. **FIBA Kampionati Evropian për Shtete të Vogla – Femra**, 23–28 qershor 2026 (Pejë);
2. **FIBA Kampionati Evropian U16 për Vajza, Divizioni C**, 4–12 korrik 2026 (Gjakovë);
3. **FIBA Kampionati Evropian U18 për Vajza, Divizioni C**, 18–27 korrik 2026 (Prizren).

Rrjedhimisht, autorizohet Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme administrative dhe organizative për aplikimin zyrtar pranë FIBA-s, si dhe të vazhdojë bashkëpunimin me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Kosovës lidhur me mbështetjen financiare dhe investimet infrastrukturore në palestrat përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben FETAHU



Federata e Basketbollit të Kosovës

